



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 22.05.2023

Nr: 124

Ora: 13:40

VENDIM

**PËR KTHIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 68, TË DEPOZITUAR NË KQZ NË DATËN 20.05.2023
NGA PARTIA "ALEANCA DEMOKRISTIANE E SHQIPËRISË"**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 22.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan	RUSMALI	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Subjekti zgjedhor "Aleanca Demokratike e Shqipërisë", përfaqësuar nga z. Petrit Dedaj

OBJEKT:

- Kundërshtim i vendimit nr. 86, datë 16.05.2023 të KZAZ nr. 76, bashkia Përmet, qarku Gjirokastrë "Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e këshillit të bashkisë Përmet".
- Rinumërim dhe rivlerësim të votave të vlefshme dhe të pavlefshme të subjekteve në kutitë e votimit për këshillin, për të gjitha QV e KZAZ, bashkia Përmet, qarku Gjirokastrë.



3. Ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për këshillin e bashkisë Përmet, duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga procesi i rinumërimit dhe rivlerësimit të votave.

BAZË LIGJORE: Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Subjekti zgjedhor “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë” ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 68 regj., datë 20.05.2023.

Në mbledhjen e datës 22.05.2023, ora 13:40, pas relativitetit të z. Ilirjan Rusmali u konstatua se kërkesa ankimore nuk i plotësonte elementet e formës të parashikuara në nenin 126, pasi është paraqitur me të meta. Konkretisht në ankim nuk është referuar vendimi që ankimohet, sipas parashikimit të nenit 126, pika 1, shkronja “b” të Kodit Zgjedhor, në përputhje me të cilën duhet saktësuar objekti i kërkesës ankimore.

Në bazë të nenit 129, pika 1, të Kodit Zgjedhor, KAS për çdo kërkesë ankimore të regjistruar bën verifikimin e ekzistencës së elementeve të formës sipas nenit 126 të Kodit Zgjedhor dhe të elementeve të përcaktuara në nenin 130 të po këtij Kodi. Në kushtet kur kërkesa ankimore objekt i kësaj procedure të plotësimit të formës dhe përmbajtjes nuk i plotëson kushtet e shkronjës “b” të pikës 1, të nenit 126, të Kodit Zgjedhor, ajo duhet t’i kthehet për plotësimin e elementeve të formës, sipas përcaktimeve të cituara si më sipër.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “c” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Kthimin e kërkesës ankimore nr. 68, datë 20.05.2023 për plotësim të elementëve të formës.
2. Seanca paraprake do të zhvillohet më datë 23.05.2023, ora 13:40.
3. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palës në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit paraparak, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

U shpall sot më datë 22.05.2023.

Ilirjan	RUSMALI	- Relator
Elvin	LAKO	- Anëtar
Elvis	ÇEFA	- Anëtar
Ledio	BRAHO	- Anëtar